



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 2.12.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Sance degjimore me UN Albania per te diskutuar ceshtje te buxhetit qe kane lidhje me Objektivat e Zhvillimit te Qendrueshem.
2. Shqyrtimi në parim i projektligjit "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit"
3. Miratimi ne parim i Paketes Fiskale dhe i projektligjit "Per Buxhetin e vitit 2020"

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Senida Mesi, Suzana Topi, Krenar Ryçi, Evis Kushi, Arben Elezi, Korab Lita, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Ervin Bushati, Ylli Shehu, Eljo Hysko, Roland Xhelilaj, Vullnet Sinaj, Artur Roshi

Mungojnë:

Reme Lala, Blerina Gjylameti, Edlira Hyseni, Anastas Angjeli

Të ftuar:

UN Albania

- Brian Williams, UN Resident Coordinator
- Michele Ribotta, UNWomen Representative
- Raul Gonzales, WHO Representative,

Ministria e Financave dhe Ekonomise

Ministrja Znj. Anila Denaj,

Zv/Minister Z. Elton Haxhi,

Z. Nikolla Lera Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Makroekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit,

Znj. Delina Ibahimaj Drejtoreshe e Tatimeve,

Z. Klodi Plloca Drejtor I IT I tatimeve.

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëmëngjesi!

Sot në rendin e ditës kemi seancën dëgjimore me UN Albania për të diskutuar çështjet e buxhetit që kanë lidhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Kishim seancë dëgjimore me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, por edhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe energjisë, por u detyruan t'i anulojmë për shkak se të dyja institucionet janë në krye të detyrës në terren dhe në alert të plotë për t'iu përgjigjur detyrimeve dhe kërkesave që mund të ketë ose që ka situata.

Ndërkohë, sot do të kemi edhe dy pika të tjera në rend të ditës. Do të jetë shqyrtimi në parim i projektligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” dhe do të kemi edhe diskutimin dhe votimin e propozimeve të komisioneve të tjera në parim.

Për informacionin tuaj, në datën 5 kemi votimin në parim në seancë të buxhetit të shtetit.

Dua t'ju informoj se është një diskutim midis qeverisë dhe nesh për ndryshime në draftin e vitit 2020. Kryeministri ka propozuar, kërkuar dhe po detajon programin e rindërtimit brenda buxhetit të vitit 2020 me filozofi të një përgjigjeje të shpejtë ndaj të gjitha pasojave të tërmetit, rindërtimin e plotë të shtëpive dhe pallateve të dëmtuara, në referencë të vlerësimit.

Ideja është për një program të veçantë, që, gjithsesi, akoma nuk është ravijëzuar plotësisht. Besoj që në ditët që do të vijnë vetë Kryeministri do ta prezantojë edhe publikisht.

Detyra jonë është që, pozita dhe opozita, menjëherë t'u përgjigjemi nevojave të situatës për të mbështetur, detajuar dhe votuar programin e rindërtimit brenda buxhetit të vitit 2020, që ndoshta nuk do të jetë vetëm brenda vitit 2020, por mund të kapë si program, në varësi të vlerësimeve të specialistëve, edhe vitin 2021.

Fjala për ju. Urdhëroni!

Brian Williams -

I nderuar Kryetar i Komisionit, z. Ahmetaj!

Të nderuar anëtarë të Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave.

Ju falënderoj për ftesën në këtë takim!

Ftesa për të marrë pjesë në këtë takim të komisionit ka ardhur para tërmetit, kështu që edhe fjala ime është hartuar paraprakisht. Prandaj, më lejoni që në emër të sistemit të Kombeve të Bashkuara

t'ju shpreh ngushëllimet tona të përzemërta për viktimat dhe për familjet e tyre si dhe vlerësimin tim për hapat e shpejtë të qeverisë dhe për bashkëpunimin e saj me partnerët ndërkombëtarë. Më vjen mirë të raportoj se Kombet e Bashkuara kanë sjellë dy ekspertë të Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për vlerësimin dhe Koordinimin e Fatkeqësive Natyrore (UNDAC) në ekipin e mbrojtjes civile të drejtuar nga BE-ja, si dhe një specialist të emergjencave shëndetësore, një ekspert komunikimi për rrezikun dhe një ekspert për Ekipet Mjekësore të Emergjencave, të mobilizuar nga OBSH-ja. UNHCR ka ofruar tenda dhe mallra jo-ushqimore, OBSH-ja mbështetje Ministrisë së Shëndetësisë, UNICEF-i po fokusohet në mbrojtjen e fëmijëve dhe mbështetjen psiko-sociale, kurse PNUD-i në garantimin e mbështetjes për shtresat e cënueshme – në këtë rast për komunitetet rome. PNUD-i po punon gjithashtu ngushtësisht me inxhinierët e strukturave për të ndihmuar në vlerësimin e dëmeve me qëllim që Shqipëria të mund të rindërtohet më mirë dhe më fort.

Isha i interesuar të merrja pjesë në këtë mbledhje sot, sepse të gjithë bashkë jemi të interesuar ta maksimizojmë shpejtësinë e zhvillimit për popullin shqiptar. Për mua nuk ka asnjë diskutim që kur vjen fjala të financimi, pjesa më e rëndësishme e këtij zhvillimi është se çfarë do të vendosni të bëni me burimet tuaja buxhetore në këto rrethana

Më lejoni të them dy fjalë për konceptin e “zhvillimit”. Ndonëse rritja e PBB-së është e rëndësishme, asaj i vihet më shumë rëndësi se duhet si një tregues i vetëm. I mungojnë faktorë domethënës, si barazia në shoqëri, mirëqenia e qytetarëve, cilësia e jetës, të drejtat e njeriut dhe përfshirja e shtresave më të dobëta. Indeksi i Zhvillimit Njerëzor – indeksi i mbështetur fuqimisht nga PNUD-i - e kryen shumë më mirë këtë funksion, pasi, duke pasur si pjesë të tij edhe jetëgjatësinë, numëron jetët dhe jo dollarët dhe pikërisht nga mënyra se si llogaritet e adreson edhe problemin e pabarazisë. Raporti i radhës global i përvitshëm i Indeksit të Zhvillimit Njerëzor do të dalë më 9 dhjetor.

Dhe që prej vitit 2015, kemi një tjetër kuadër të fortë brenda të cilit mund të analizojmë zhvillimin, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, ose Axhendën 2030. Kjo paketë prej 17 Objektivash – për të cilën është angazhuar çdo qeveri në botë, përfshirë edhe atë shqiptare – përshkruan vizionin e një shoqërie të qëndrueshme, ku ka arsim dhe kujdes shëndetësor, ujë të pastër dhe ushqim të sigurt për të gjithë qytetarët; një shoqëri ku gratë kanë të drejta të barabarta dhe ku mund të ecin dhe të drejtojnë pa frikë; një ekonomi që u ofron të gjithëve rrugë drejt një angazhimi produktiv; si dhe një vend që i mbron burimet e veta natyrore për të gjithë qytetarët e tij, për këtë brez e të tjerë që do vijnë.

Në këto minuta që me bujari po më lejoni sot, do të doja të mbroja idenë që në diskutimet tuaja të merrni parasysh se si duhet t'i përdorni financat tuaja sot për të përshpejtuar sa më mirë arritjen e këtyre Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Në vitin 2018, sistemi i Kombeve të Bashkuara – që të gjitha 8 agjencitë e tyre rezidente në Shqipëri dhe shumë zyra të tjera – ndërmorën një analizë së bashku me qeverinë dhe partnerët e saj për të parë se si mund të përshpejtohen OZHQ-të. Ky vlerësim është pasqyruar në buxhet.

Nga ky vlerësim dolën tre klastera pune që mund të përshpejtojnë zhvillimin e Shqipërisë dhe të përshpejtojnë arritjen prej saj të Axhendës 2030. Ajo çka i karakterizon Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm është se ato janë që të gjitha të lidhura me njëra-tjetrën. Është si kubi Rubik. Kur merresh me njëren faqe të asaj gjëgjëze – diçka ndryshon edhe tek tjetra. Kështu që duhet parë se si funksionojnë që të gjitha bashkë.

Klasteri i parë i përshpejtimit është fokusimi te programet në fushën e shtetit të së drejtës dhe mirëqeverisjes. Këtu, do të doja të ngrija dy pika:

- E para, nga këndvështrimi i popullit shqiptar, nuk është thjesht çështje korrupsioni apo vetingu, ajo çka është e rëndësishme është *aksesi në drejtësi*. A do të ketë mundësi çdokush

të marrë një mbrojtje ligjore që mund ta përballojë ekonomikisht? A do të ketë seanca të drejta në gjykata? Për ta arritur këtë, duhet investuar në disa prej mekanizmave të sigurisë që funksionojnë për mbrojtjen e këtij aksesit në drejtësi. E kam fjalën për investime të mjaftueshme në ndihmë ligjore falas; financime të mjaftueshme për institucionet e pavarura të drejtave të njeriut si Komisioneri kundër Diskriminimit apo Avokati i Popullit; si dhe financim të qenësishëm dhe hapësirë që OJQ-të të mund të operojnë, pasi ato janë shpesh mbrojtësit më të fuqishëm të komuniteteve, siç po ndodh p.sh. sot, për ato OJQ që përpiqen të garantojnë drejtësinë në fushën e mjedisit. A po investohet në këto institucione kaq të rëndësishme në buxhetin e këtij viti? E vërteta e sinqertë është se pa këta mekanizma garantues, e drejta e qytetarëve që nuk kanë lidhje dhe para shpërfillen tepër lehtë. Nëse ju interesojnë këto të drejta, duhet të investoni në institucionet që i mbrojnë ato. Kjo është mënyra se si fitohet besimi i qytetarëve se qeveria po interesohet vërtet për mirëqenien e tyre.

- E dyta, në vitin 2015, Qeveria bëri një hap shumë të madh përpara për rikonfigurimin e territorit administrativ për krijimin e 61 bashkive. Këtyre bashkive iu është dhënë më shumë autoritet për të menaxhuar zhvillimin e tyre; si dhe u janë ngarkuar përgjegjësi mjaft më të mëdha sa u përket shërbimeve dhe mbrojtjes së mjedisit. Megjithatë, ato nuk kanë marrë burime financiare ndjeshëm më të mëdha. Disa prej tyre, po, kanë marrë, por jo aq sa të nxisin krijimin e mundësive të vërteta ekonomike dhe as që të menaxhojnë në mënyrë të besueshme dhe me sukses burimet e tyre natyrore.

Klasteri i dytë i përshpejtimit është fusha që ne e quajmë ‘ekonomia e gjelbër, gjithëpërfshirëse’.

Me fjalë të tjera, fokusimi tek mundësitë ekonomike, por në mënyra që janë të qëndrueshme nga ana mjedisore dhe që maksimizojnë mundësitë për njerëzit e zakonshëm. Rritja gjatë viteve të fundit, e nxitur nga investime të mëdha si TAP dhe investimet në fushën hidro-energjetike janë të rëndësishme për kombin, por nuk sjellin një punësim intensiv. Përveç këtyre investimeve të mëdha, në rritje ka kontribuar edhe një konsum më i madh, i ndihmuar nga remitancat e konsiderueshme të shqiptarëve jashtë shtetit.

Si reagim në këtë kontekst, fokusimi tek ‘ekonomia e gjelbër, gjithëpërfshirëse’ mund të çojë në përqendrimin në më shumë fusha të energjisë së rinovueshme, si energjia diellore dhe ajo e erës. Këtu mund të përfshihet trajnimi – inxhinierët dhe formimi profesional i teknikienëve – në këto fusha. Kapitalizimi i bazuar tek shkalla e punësimit në Shqipëri, rritja e investimeve në trajnimin në fushën e teknologjisë së informacionit – edhe këtu në nivel terciar dhe të formimit profesional – mund ta ndihmojnë Shqipërinë të kalojë në revolucionin e saj të katërt ekonomik. Dhe këtu përfshihet patjetër fokusimi tek eko-turizmi, turizmi i qëndrueshëm. Natyra e pasur dhe mikpritja e Shqipërisë janë një prej asetëve të saj më të mëdha dhe duhet të menaxhohen me kujdes për t’u siguruar se përfitimet ekonomike prej saj ndahen mes një numri të madh njerëzish dhe se prej tyre mund të përfitojnë edhe brezat e ardhshëm.

Gjithëpërfshirja është një tjetër faktor kyç për uljen e varfërisë dhe pabarazisë. E përgëzoj qeverinë për kalimin e ligjit për nxitjen e punësimit këtë vit. Me zbatimin e ligji, investimet që qeveria bën në punësim duhet që, përmes tij, të çojnë në punë të qëndrueshme për individët, duke u fokusuar rast pas rasti dhe jo thjesht duke subvencionuar biznese të caktuara. Ligji për nxitjen e punësimit përfshin edhe elementë për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, si duke njohur detyrimet e punëdhënësve sa i përket krijimit të një ekonomie gjithëpërfshirëse, ashtu edhe krijimit të më shumë mundësive për personat me aftësi të kufizuara, që ata të mund të jenë kontribues produktiv në shoqëri.

Një element thelbësor për uljen e varfërisë dhe rritjen e gjithëpërfshirjes është edhe përfshirja më e madhe e grave në forcën zyrtare të punës. Veçanërisht në zonat rurale, gratë kontribuojnë me punë

të papaguar dhe të pavlerësuar në ferat familjare. Informaliteti i punës së tyre nuk u lejon familjeve të marrin kredi, të bëhen biznese të vogla e të rriten. Për rritjen e angazhimit të grave në krahun zyrtar të punës kërkohet zbatimi i të drejtave ligjore ekzistuese, ndryshime të tilla në kulturë që u japin grave një vend të barabartë në mjedisin e punës, si dhe politika që përkrahin më shumë barazinë dhe familjen, si investimet në kujdesin për fëmijët dhe kujdesin për të moshuarit. Në fakt, investimet më të mëdha qeveritare në kujdesin për fëmijët dhe kujdesin për të moshuarit përbëjnë një shembull politikash ku të gjithë fitojnë: shumica e vendeve të reja të punës të krijuara në këto fusha janë për gratë, duke rritur kështu punësimin e grave në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe duke iu dhënë në të njëjtën kohë grave mundësinë për të hyrë në tregun zyrtar të punës [me përfitimet e një mbështetjeje më të madhe për kujdesin për fëmijët dhe kujdesin për të moshuarit]. Disa studime kanë treguar se investimet në të ashtuquajturën 'ekonominë e kujdesit' kanë më shumë efekte ekonomike të shumëfishta sesa investimet e tjera tradicionale, si infrastruktura e transportit. Sa i përket fuqizimit të grave, do të doja të shprehja vlerësimin për një progres të rëndësishëm, jo vetëm në fushën e pjesëmarrjes politike në qeveri, por edhe në mirë-integrimin e Raportimit të Përgjegjshëm Gjinnor, si dhe për programet si ai i përfitimeve sociale nga sigurimet shoqërore.

Klasteri i tretë i përshpejtimit janë investimet në kapitalin njerëzor dhe social. Për ta thënë troç: shpenzimi i parave për arsim dhe kujdes shëndetësor nuk është luks, është investim. Është investim në të drejtat e njeriut; është investim për besimin e njerëzve të qeveria dhe te sistemi demokratik; si dhe investim në ekonomi. Me ngjitjen e vendeve më lart në shkallën ekonomike konkurruese, investimi më i rëndësishëm është ai në arsimin e mesëm dhe të lartë, investimi në kërkime shkencore dhe zhvillim, si dhe në formim profesional. Megjithatë, investimet e qeverisë në arsim dhe në kujdesin shëndetësor në Shqipëri, duke përfshirë edhe buxhetin e vitit të ardhshëm – ku për çdo vit llogaritet të jetë nën 3% të PBB-së (me fjalë të tjera, si pjesë e pasurisë) – janë disa pikë përbindje poshtë vendeve të tjera në nënrajon dhe në Evropë. Ajo çka ne e quajmë 'shpenzime xhepi' për kujdesin shëndetësor nga vetë qytetarët është në shifra shumë të larta. Do të doja të vlerësoja se Strategjia Kombëtare e Shëndetit ka vendosur një objektiv për rritjen e shpenzimeve për kujdesin shëndetësor – deri në 4% brenda vitit 2025. Ky Komision ka fuqinë të garantojë arritjen e këtij objekti. Thënë thjesht, Shqipëria nuk është aq e pasur sa vendet mesatare të BE-së sot, por nuk ka arsye se pse Shqipëria të mos investojë një shifër të ngjashme në këto fusha kritike, sado që të jetë pasuria e saj.

Mund të shohim edhe një koncept pak më të gjerë të investimeve sociale dhe ta quajmë atë mbrojtje sociale. Këtu përfshihet ndihma ekonomike dhe skemat e pagesës për aftësi të kufizuar, [si dhe shëndetësia dhe arsimi]. Edhe këtu, përqindja e pasurisë shqiptare që po investohet për mbrojtjen sociale është nën nivelin e vendeve të tjera në këtë nënrajon, si mes vendeve që janë në fazën e aderimit në BE, ashtu edhe të vendeve fqinjë anëtare të BE-së. Në fushën e shpenzimeve për mbrojtje sociale, tendencat në fakt këto 25 vitet e fundit në Evropën jugore dhe lindore kanë qenë mjaft të qëndrueshme. Po të kthehemi në vitin 2015, Itali, Austria dhe Greqia që të gjitha i kushtuan rreth 25% të PBB-së – një të katërtën e pasurisë kombëtare – shumë që u shpenzua për "mbrojtjen sociale", kurse Kroacia dhe Serbia ishin mbi nivelin e 20%. Megjithatë, Shqipëria qëndroi afër 13%.

Një mekanizëm që mund të ndihmojë është Fondi Social, i ngritur këtë vit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, një mekanizëm për rritjen e investimeve për mbrojtjen sociale në nivel Bashkie përmes një bashkëpunimi më të mirë mes Bashkive dhe shoqërisë civile. Ne ju inkurajojmë që ta zgjeroni këtë nismë në vitet e ardhshme.

Dhe e fundit, mund të jetë momenti për të filluar e për të parë më nga afër gjendjen e emigrantëve dhe azilkërkuesve. Përveç marrjes parasysh të të drejtave të njeriut dhe duke theksuar reputacionin e shkëlqyer të Shqipërisë sa i takon respektimit të atyre të drejtave, Shqipëria mund të dojë të fillojë të investojë për integrimin e atyre azilkërkuesve, një numër i vogël po me gjasë në rritje, që

dëshirojnë të qëndrojnë në Shqipëri, në mënyrë që ata të mund të bëhen aktivë dhe agjentë energjikë të zhvillimit.

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Ndonëse kjo analizë e jona e përbashkët vë në dukje se këto tre fusha mund ta përshpejtojnë zhvillimin, ajo çka mund të ndihmojë përtej kësaj është edhe një plan investimesh për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Kjo është diçka, ku Kombet e Bashkuara do të ishin të kënaqura të ndihmonin.

Ajo çka kemi bërë deri tani janë përpjekjet për të vlerësuar shpenzimet aktuale të buxhetit vitet e fundit – sidomos për vitin 2015, 2016 dhe 2017 – sa u përket OZHQ-ve. Sipas llogaritjeve tona, investimet e qeverisë shqiptare për OZHQ-të shkojnë afërsisht 18% të PBB-së. Për të qenë i sigurtë, ne në këtë pikë nuk kemi një opinion nëse kjo shumë është më shumë apo më pak se sa duhet (ndonëse dyshojmë se është shumë pak!), por do të ishim të interesuar të punonim më shumë me ju për të pasur një plan më proaktiv në këtë aspekt.

Unë e di, të nderuar anëtarë, se ju bie tashmë të mbani mbi shpatulla edhe përgjegjësi të tjera në lidhje me tërmetin. Si Kombet e Bashkuara, ne do të bëjmë sigurisht çmos që partnerët tuaj financiarë t'ju vijnë në ndihmë sa i përket rindërtimit. Përveç kësaj, ne jemi gjithashtu që ky komision të gjejë mënyrat për ta mbajë përsipër barrën e rindërtimit pa sakrifikuar investimet e rëndësishme në kapitalin njerëzor.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Arben Ahmetaj - Faleminderit, Brajan!

Unë gjej rastin t'ju falënderoj personalisht dhe Kombet e Bashkuara për mbështetjen që na keni dhënë në vazhdim, jo vetëm për çështjet në fjalë, por për gjithçka që na ka shoqëruar në periudhën e tranzicionit, të zhvillimit dhe sot që gjendemi në një situatë të jashtëzakonshme, pos -tërmet, ku Shqipëria ka kaluar dhe po kalon nëpërmjet një dhimbje të madhe për shkak të humbjes së jetëve të qytetarëve të saj dhe një shkatërrimi masiv në disa rajone të vendit. Jam i bindur që si gjithmonë, ju do të gjendeni pranë popullit shqiptar shpirtërisht, institucionalisht, por edhe financiarisht për të mbështetur “paketën e rindërtimit” që po harton Kryeministri.

Ka pyetje, i referohem Barajan, sepse e kam mik dhe kam një komunikim disavjeçar, për personat e ftuar në komision?

Po, zonja Kushi.

Evis Kushi - Faleminderit!

Zoti William, shumë faleminderit për prezencën tuaj sot këtu në komision, për fjalën tuaj, siç e tha edhe zoti Ahmetaj për mbështetjen që Kombet e Bashkuara i kanë dhënë në mënyrë të vazhdueshme Shqipërisë, por sidomos në këtë situatë të jashtëzakonshme, një mbështetje jo vetëm materiale, por sidomos me ekspertë, me grupe specialistësh, për menaxhimin e kësaj situate të jashtëzakonshme që po kalon Shqipëria.

Kalojmë te pyetja që kisha për ju. Ju falënderoj edhe për fjalën, që na e keni vënë në dispozicion!

Ka një çështje, për të cilën të gjithë biem dakord: se arritja sa më shpejt e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, është interesi ynë i përbashkët. Prandaj, pyetja ime lidhet pikërisht me këtë: ne, si parlamentarë, si anëtarë të parlamentit, por edhe si Komision i Ekonomisë, çfarë mund të bëjmë më shumë, sipas opinionit tuaj, pikërisht për t'i arritur sa më shpejt këto objektiva, në mënyrë sa më të plotë? Çfarë kontributi shtesë mund të japim ne? Ku mund të fokusohemi më shumë, në mënyrë që kjo të bëhet realitet?

Faleminderit!

Brian Williams – Faleminderit shumë për pyetjen! Pikë së pari, do të doja të thosha se parlamenti, në përgjithësi, ka një rol të rëndësishëm për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Në fakt, është hedhur prej kohësh ideja që, kur ministritë e linjës të prezantojnë projektligje të caktuara, në fusha të caktuara, është mirë që ato t'i shpjegojnë parlamentit se si kontribuojnë këto projektligje në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Siç e kam shkruar edhe në fund të fjalimit tim, hartimi i një plani specifik investimesh për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, është diçka ku ne do të donim të bashkëpunonim me shumë kënaqësi me qeverinë. Pra, të shihnim se si ky komision mund të ketë një perspektivë më afatgjatë të arritjes së objektivave, duke përdorur edhe burimet e vetë qeverisë.

Ashtu sikurse e theksova edhe në fjalën time, ne i shohim gjithashtu shumë të rëndësishme edhe investimet në burimet njerëzore. E kam fjalën për investimet në arsim, investimet në kujdesin shëndetësor, investimet në formimin profesional të njerëzve.

Diçka e fundit, që ka të bëjë me mjedisin: Shqipëria është me fat që shumicën e energjisë, pothuajse të gjithën, e prodhon nëpërmjet hidrocentraleve. Gjithsesi, qoftë reshjet, qoftë vetë hidrocentralet, kanë për t'u prekur nga ndryshimet klimatike, prandaj është mirë që të merren masa për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen nga pasojat e mundshme në mjedis, e kështu me radhë.

Nëse më lejoni, do të doja të shtoja edhe diçka, e cila ka të bëjë me lidhjen që ka integrimi i Shqipërisë në Bashkimin European, me arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Pra, siç thashë, integrimi i Shqipërisë në Bashkimin European është shumë i lidhur me arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, sepse, në fund të fundit, integrimi në Bashkimin European do të thotë jetë më e mirë e qytetarëve, mirëqenie e qytetarëve, gjë që përshkruhet më së miri në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Prandaj, ne duam që çdo

ministri linje ta shikojë pikërisht nga kjo perspektivë çdo projektligj apo çdo dokument që ajo harton.

Ndoshta, një gjë shumë e rëndësishme që parlamenti mund të bëjë, është t'i ndjekë zhvillimet apo propozimet e ministrive të linjës jo vetëm për të parë se si i përmbushin ato qëllimet e Shqipërisë në kuadrin e integritit në Bashkimin Europian, po për të parë edhe se si ndikojnë ato në arritjen sa më shpejt të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Pikërisht këtu, parlamenti, anëtarët e parlamentit, mund të bënin pyetje në punën e tyre.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, ju lutem, zoti Roshi!

Artur Roshi – Për të mos përsëritur falënderimet që bënë kolegët, adresuar institucionit që ju përfaqësoni, po bëj një pyetje konkrete: si e vlerësoni ju partneritetin publik privat, atë që ne e quajmë PPP? Cila është influenza e tyre në ekonominë e vendit? A e rrisin këto zhvillimin e qëndrueshëm, që ju i përmbaheni aq fort, apo e bëjnë atë më të brishtë?

Ju faleminderit!

Brian Williams – Faleminderit për pyetjen!

Në fakt, të rëndësishme për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm janë investimet. Kur themi 'investime', kemi parasysh investimet në kapitalin njerëzor, investimet në arsim, investime në kujdesin shëndetësor, investime për mbrojtjen e mjedisit, investimet për fuqizimin e grave, si dhe çështje të tjera. Pra, ajo çfarë ne theksojmë është investimi në këto fusha.

Ajo që na intereson më shumë, është: për çfarë investohet? Pastaj, sa i përket mënyrës se si investohet, me PPP apo pa PPP, kjo varet nga specifikat që kanë vendet, përfshirë edhe Shqipërinë. Kur vjen fjala te mënyra e investimit, ne jemi në të njëjtën linjë me organizatat e tjera ndërkombëtare, si FMN-ja për shembull, por ne i ndjekim këto zhvillime.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, Brajan!

Ka ndonjë pyetje tjetër? Nëse nuk ka pyetje, unë do t'i bëja një kërkesë Brajanit dhe gjithë institucionit që ai përfaqëson sot. Do ta vlerësoja shumë nëse në janar ose në shkurt, do të organizonim një *workshop* me komisionin, në mënyrë që ky komision, por edhe komisionet e tjera, të cilat preken dhe prekin të gjitha objektivat e zhvillimit të mileniumit, të mijëvjeçarit, në mënyrë që të kemi mundësi të bëjmë dy punë të rëndësishme në këtë dimension. Pikësëpari, kur ky komision diskuton, qoftë opozita, qoftë pozita, apo komisionet e tjera, t'i dallojnë qartë si programe e si zëra: pra, çfarë programesh dhe çfarë zërash në buxhet i përgjigjen objektivave specifike. Sepse, sigurisht, buxheti është një nga elementët e zhvillimit.

E dyta, të kemi një strukturë skanimit, një model, një program të thjeshtë skanimit të të gjitha objektivave, kur vjen puna për të gjykuar se si kanë funksionuar dhe çfarë arritjesh kemi në secilën nga këto? Kjo përputhet tërësisht me punën tonë si Kuvend, që monitorojmë qeverinë, por edhe mbështesim të gjithë objektivat tërësorë të zhvillimit. Kjo do të na pajiste me një dituri teknike të detajuar për të ndjekur shtyllë pas shtylle objektiv pas objektivit se si jemi, duke ecur me këtë që po flasim, pra me objektivat e mijëvjeçarit. Besoj se komisioni bie dakord me këtë?

Brian Williams – Faleminderit për sugjerimin, zoti kryetar!

Në fakt, mund t'ju jap përgjigje tani. Patjetër, absolutisht me shumë kënaqësi do të organizonim këtë *workshop* me këtë komision, por ndoshta edhe me komisione të tjera, puna e të cilave lidhet me objektivat. Ndoshta për të tjerët mund të japin një përditësim të objektivave.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 2.12.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Senida Mesi, Suzana Topi, Krenar Ryçi, Evis Kushi, Arben Elezi, Korab Lita, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Ervin Bushati, Ylli Shehu, Eljo Hysko, Roland Xhelilaj, Vullnet Sinaj, Artur Roshi

Mungojnë:

Reme Lala, Blerina Gjylameti, Edlira Hyseni, Anastas Angjeli

Të ftuar:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministrja Znj. Anila Denaj,

Zv/Minister Z. Elton Haxhi,

Z. Nikolla Lera Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Makroekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit,

Znj. Delina Ibahimaj Drejtoreshe e Tatimeve,

Z. Klodi Plloca Drejtor i IT i tatimeve.

Arben Ahmetaj - Ashtu siç ju informova, ne sot kishim Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, por për shkak se të dy drejtuesit dhe stafet e tyre janë në terren që nga mëngjesi deri në darkë, ne e anulua dëgjuesën dhe po kalojmë te relatimi i ligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”. Edhe Ministria e Financave është në të njëjtën situatë, pra drejtuesit janë duke u marrë me punët që kanë të bëjnë me situatën e jashtëzakonshme. Unë me dakordësinë e pjesës së maxhorancës, por besoj se e kam edhe nga ju do të bëj relatin. Mund të mbani qëndrime, pra ato që keni për të thënë. Nen për nen do të hyjmë në detaje, sepse drafti ka nevojë për diskutime dhe për përmirësime serioze, për të mos krijuar një konfuzion në terrenin fiskal, por edhe për të realizuar atë qëllim për të cilin është bërë: të ulë evazionin dhe të krijojë një sistem që, kur e shikojmë dhe e lexojmë në detaje teknike është shumë i mirë, do të ndihmojë informacionin, do të ndihmojë uljen e informalitetit, do të ndihmojë qartësinë e institucionit, por edhe të sipërmarrjes. Besoj se nuk do ta kemi problemin e vjetër të kryqëzimit të faturave me lloj-lloj

niptesh që flenë ose që mbyllen dhe më pas bëjnë evazion duke bërë faturime të ndërsjella. Pra, drafti në tërësi është një draft shumë i domosdoshëm, i rëndësishëm, i mirë, por ne kemi nevojë, që kur të diskutojmë nen për nen, të kemi mundësinë që ta rregullojmë. Megjithatë, ju mund të mbani qëndrimet tuaja në lidhje me draftin. Unë si relator po kaloj relatimin e përgatitur nga komisioni.

Baza ligjore kushtetuese është tradicionale, pra do t'u referohemi neneve 78 dhe 83 të Kushtetutës dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Projektligji i propozuar ka për qëllim krijimin e një sistemi të ri faturimi dhe monitorimi të transaksioneve të bizneseve në vend, bazuar në një sistem të ri të pajisjeve fiskale, siç u referohemi, gjenerata e re e kasave fiskale. Për të mundësuar plotësimin e qëllimit, projektligji propozon, parime, rregulla, detyrime, afate dhe procedura që duhet të ndiqen nga taksapaguesit dhe prodhuesit dhe mirëmbajtësit e zgjidhjeve *softwaere* gjatë aktivitetit të tyre në lidhje me mënyrën dhe formën e lëshimit të faturave, për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, përfshirë faturën elektronike në transaksionet pa para në dorë, për mbajtjen e faturave dhe procesin e fiskalizimit, për marrjen e informacionit të pagesave, për faturat elektronike të lëshuara dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji. E gjithë kjo paketë rregullash procedurale dhe detyrimesh, që trajtohen përmes këtij projektligji, ka për synim përmirësimin e miradministrit tatimor dhe rritjen e mbledhjes me efeciente të të ardhurave tatimore përmes mundësimin të ndjekjes në çdo hallkë të të gjithë zinxhirit të transaksioneve.

Gjithashtu, nisma vjen në kuadër të të gjithë frymës të projektligjeve financiare që shoqërojnë projektligjin për buxhetin e vitit 2020, e cila në themel të saj ka miradministrit tatimor dhe luftën kundër informalitetit. Në afat më të gjatë, implementimi i këtij projektligji mendohet të sjellë më shumë efektivitet në procedura, auditim special të tatimpaguesve më risk të lartë, si dhe më shumë transparencë dhe kontroll në shpenzimet qeveritare për shkak të faturës elektronike të detyrueshme në lidhje me institucionet publike. Modernizimi i formës dhe procedurave të lidhura me transaksionet përmes llogarive bankare do të nxisë kryerjen e pagesave jo kesh në transaksionet e biznesit. Sipas studimeve të Bankës Botërore dhe Bankës së Shqipërisë, përdorimi më i lartë i metodave të pagesave jo kesh në vend të pagesave kesh do të ulë shpenzimet e pagave, pasi analizat kanë treguar se pagesat kesh janë më të shtrenjta.

Projektligji do të mundësojë fiskalizimin e faturave në furnizimin e mallrave, të shërbimeve dhe të faturave shoqëruese që konsistojnë në një sërë masash të zbatuara nga tatimpaguesit për të mundësuar kontrollin efikas të qarkullimit të realizuar me para në dorë apo në formë të pagesave pa para në dorë dhe kontrollin e lëvizjes së mallrave.

Gjithashtu, projektligji synon edhe krijimin e një sistemi menaxhimi dhe kontrolli të faturave që i referohemi MKF, që konsiston në një tërësi procedurash dhe mjetesesh ligjore, organizative dhe teknike, të cilat kanë për qëllim kontrollin e transaksioneve me pagesa me para në dorë dhe pagesa me para jo kesh. Përdorimi i teknologjisë më moderne do t'i mundësojë administratës tatimore pajisjen e një pasqyre të qartë për secilën llogari. Për më tepër, do të krijohet një instrument i vlefshëm statistikor dhe analitik për mbikëqyrjen e risqeve tatimore, për monitorimin efektivitetit të strukturës organizative dhe segmenteve të saj, si dhe të zyrtarëve të administratës tatimore. Tatimpaguesit do t'i nënshtrohen fiskalizimit dhe duhet të lëshojnë faturë, pavarësisht nga qarkullimi vjetor i realizuar në vitin paraardhës ose aktual. Sipas propozimit të këtij projektligji, janë personat fizikë ose juridik, të cilët janë subjekt të tatimit, të tatimit të thjeshtësuar mbi fitimin për biznesin e vogël, në përputhje me legjislacionin në fuqi, respektivisht për tatimin mbi të ardhurat në sistemin e taksave vendore, tatimpagues, të cilët pavarësisht nga forma e organizmit përfshirë, dhe organizatat jofitimprurëse njësitë e zbatimit, projekte dhe organet publike qendrore, vendore, organizatat politike dhe institucionet e tjera të ngjashme, të cilat ushtrojnë veprimtari ekonomike janë subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për TVSH-në, rezident ose jorezident, pavarësisht nga forma e organizimit, kur furnizon mallra ose shërbime për organet publike, jorezident për furnizimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, kur vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi tatimor i nënshtrohen detyrimeve tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat në sistemin e taksave vendore dhe TVSH-në.

Tatimpaguesit që përjashtohen nga aplikimi i detyrimeve të projektligjit: prodhuesit bujqësorë, që janë subjekt i skemës së kompensimit në përputhje me ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar; shitja e biletave ose kuponëve nga shoferi i një mjeti transporti pasagjerësh në linjat e transportit publik urban, sipas përcaktimeve të vendimeve të njësitë të vetëqeverisjes vendore; përfitimet nga aplikimi i sistemit të fiskalizimit; mbledhja më e mirë e taksave; reduktimi i ekonomisë informale; thjeshtësimi i gjurmueshmërisë së pagesës; rritja e deficencës në raportin tatimor; aplikimi i modulit të riskut; identifikimi i parregullsive; impakt në modernizimin e biznesit dhe digjitalizimin e ekonomisë, sigurisht edhe modernizimi i sistemit tatimor.

Fiskalizimi nuk është taksë e re. Të gjithë tatimpaguesit aktualisht pjesë e skemës dhe pagesës së rregullt të detyrimit do të ndryshojnë thjesht aplikimin e përdorimit për shkak të teknologjisë së re. Në fokus të këtij procesi do të jenë tatimpaguesit, të cilët aktualisht nuk deklarojnë dhe nuk kanë paguar detyrimet që ata kanë bazuar në legjislacionin në fuqi.

Këtu po ndaloj për arsye se këto do t'i diskutojmë nen për nen. Sot kemi një agjendë të ngjeshur, pasi do të votojmë edhe propozimet e komisioneve, por do të votojmë në parim edhe buxhetin e shtetit. Zonja Ministre, për shkak të vonesës suaj legjitime, vendosëm që sot të rehatojmë dhe të votojmë në parim. Si komision vendosëm që gjatë kalimit nen për nen të projektbuxhetit, pasi këtu ka shumë çështje që do të duhet t'i skrutinojmë, të propozojmë ndryshimet e duhura një pjesë të të cilave i kemi diskutuar më parë bashkë, një pjesë tjetër mund të na dalë nga reflektimet që do të ketë komisioni nen për nen.

Nga ana procedurale, për shkak se zonja Gjylameti nuk është prezent dhe ishte relatore, e mora unë përsipër ta bëj relatimin në vend të saj. Zonja Ministre, ju jeni e justifikuar për shkak të takimit që kishin te Presidenti, por edhe për shkak të qenies suaj në terren, por kjo nuk do të thotë që stafi juaj të ketë ndonjë justifikim për të mos qenë i pranishëm në komision.

Për ta konkluduar mendoj të ecim nga ana procedurale, relatimi nga ana ime u bë, 2-3 qëndrime ose 1 qëndrim nga maxhoranca dhe 1 nga opozita, megjithatë nëse përfaqësuesit e opozitës duan të flasin të gjithë, mund ta bëjnë, ta votojmë projektligjin në parim dhe më pas gjatë miratimit nen për nen të jenë prezent shkruajtësit e ligjit, teknikët, por edhe ju në mënyrë që vendimet që marrim të jenë sa më shpejta.

Po zonja Ministre.

Anila Denaj – I nderuar, zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Kam dy elemente të rëndësishme, i pari është procedural, por edhe për efekt të kohës jemi lajmëruar për në orën 11:00. Ne jemi të pranishëm në orën që është bërë lajmërimi dhe besoj se kjo nuk justifikohet me asnjë angazhim tjetër, por me prezencën tonë këtu, sepse duam të relatojmë nga këndvështrimi ynë, si dhe të shprehemi se çfarë mendojmë për këtë projektligj dhe se çfarë do të na sjellë ai.

Nëse më lejoni, dua të bëj një prezantim të shkurtër pa ju marrë shumë kohë dhe jam e hapur për çdo gjë që ju mund të kenë. Gjatë shqyrtimit të buxhetit nen për nen për mund të ketë diskutime, por edhe ndryshime, nëse ju do t'i shihni si të arsyeshme.

A më lejoni të bëj një prezantim?

Arben Ahmetaj – Do t'ju lutesha zonja Ministre, meqë procedura ndryshoi, të ishit sa më koncize në mënyrë që ta kalojmë buxhetin e shtetit në parim. Gjatë diskutimit nen për nen do të kërkoja praninë tuaj së bashku me stafin teknik.

Faleminderit!

Anila Denaj – Projektligji “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” ose siç quhet shpesh “Projekti i fiskalizimit” vjen si një qasje sistematike ndaj informalitetit në

ekonomi dhe tentativave për evazion fiskal. Ne mendojmë se kjo do të jetë mënyra, e cila do ta ndryshojë në mënyrë të rrënjësishme sjelljen e informacionit në kohë reale për t'i analizuar këto fenomene nga strukturat përgjegjëse, konkretisht Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në kohë reale me përgjegjshmëri, sipas të gjitha rregulloreve të brendshme, të cilat janë duke u adoptuar, sikurse edhe strukturat e vetë organizatës që do t'i shkojnë për shtat këtij organizimi të ri legjislativ. Më lejoni t'ju theksoj, që për këtë të fundit kemi edhe mbështetjen e FMN-së, për të sjellë një strukturë organizative të administratës tatimore moderne, e cila t'i përqaset jo vetëm sistemit që po prezantojmë sot në kontekstin e një kuadri ligjor i ardhur në ndihmë të këtij sistemi, por edhe asaj që ka nevojë gjithë kuadri ynë praktik në raport me evidentimin e informalitetit, aty ku evazoni dhe informalitetit janë më të lartë, si dhe marrjen e masave se si do të luftohet në vijueshmëri.

Në raport me këtë projektligj janë disa elemente, por në mënyrë të përmbledhur do t'ju jap disa pika:

- rikonceptim të pajisjeve fiskale, duke kaluar nga pajisjet hard në *software*, të cilat bëjnë të mundur t'u japin një oportunitet më të madh të gjitha pajisjeve *hardware* dhe kasave ekzistuese dhe të kalojmë në një zgjidhje *software* të përshtatshme për të gjitha këto oportunitete *hardware* që ekzistojnë;
- raportim në kohë reale të transaksioneve të çdo tatimpaguesi nga raportimi ditor që bëhet sot aktualisht;
- raportim në administratën tatimore të të gjitha importeve nëpërmjet faturës, duke mundësuar kështu monitorimin në kohë reale të të gjithë zinxhirit të tregtimit të produkteve. Edhe importuesit kanë detyrimin që brenda 3 ditëve nga importi i mallit të paraqesin një faturë pranë administratës tatimore;
- çdo mall do të shoqërohet me kodin e produktit, sipas nomenklaturës së kombinuar të mallrave dhe kjo do ta ndihmojë administratën tatimore në identifikimin e të gjitha hyrjeve në import të mallrave;
- hapja e tregut të shoqërive IT që ofrojnë fiskalizimin e faturave. Certifikimi i tyre nuk do të jetë i limituar në kohë, por do të jetë pa afat;
- konkurrenca nëpërmjet kompanive IT në treg dhe atyre që ofrojnë sot zgjidhje do të na mundësojë edhe kosto më të ulëta për projektin e fiskalizimit, të cilat sigurisht përtej diskutimit të sotëm do të shoqërohen me vendime të Këshillit të Ministrave dhe do të jenë publike në momentin që ato do të jenë të gatshme për publikun;
- inventarizimi i mallrave dhe aseteve të çdo biznesi;
- sipërfaqja e vendit të ushtrimit të biznesit;
- lloji i pronësisë apo qiradhënies;

- numri i punonjësve;
- monitorimi i kohës së aktivitetit shitës;
- kontrata me kompanitë e internetit;
- të dhënat për transaksionet;
- llojet e kontratave, mënyrat e pagesave; monedha e pagesës; data e pagesës e të tjera;
- parambushje nga sistemi i dokumenteve tatimore të tilla si libri i blerjes, shitjes së TVSH-së, deklarimet e TVSH-së;
- evidentimi ditor i gjendjes së arkës së çdo biznesi.

Gjendja e arkës ka përbërë gjithmonë një element abuziv.

Më lejoni t'ju theksoj se kjo ka qenë një pikë diskutimi edhe me grupet e interesit dhe pak më vonë do t'ju raportoj që ka qenë një nga projektligjet, i cili ka pasur jo vetëm vëmendjen e Ministrisë së Financave gjatë kohës që u hodh për konsultim publik, por edhe të të gjitha grupeve të interesit. Mund t'ju them që kemi bërë një konsultim publik model me të paktën 12 grupe interesi, të cilat kanë diskutuar nen për nen dhe 4 prej neneve janë ndryshuar rrënjësisht me kontributin e tyre, një prej tyre është për gjendjen e arkës së çdo biznesi, i cili jo vetëm që është konceptuar si një element i shtuar për t'u kontrolluar në vijim, por edhe për të qenë brenda parametrave realë që lejon biznesi në kushtet që ekziston sot transaksioni.

Me qëllim uljen e kostove të tatimpaguesve për kategori biznesi, të cilat do të caktohen nga Këshilli i Ministrave, është përcaktuar që fiskalizimi i faturave nëpërmjet një portali të veçantë të krijojë mundësi edhe të një lehtësie ekonomike. Besoj se vendimi i Këshillit të Ministrave do ta bëjë të mundur se cili është kategoria e bizneseve që do të jenë brenda këtij përfitimi, portalit të veçantë të ofruar falas.

Në fund, duke qenë se sektori i hidrokarbureve ka specifika të transaksioneve me konsumatorin final biznesin, është caktuar që skema e monitorimit të qarkullimit të tyre të përcaktohet me një VKM të veçantë.

Siç jua thashë pak më parë, meqë nuk dua të zgjatem shumë te pjesa e procesit të konsultimit publik, dua të falënderoj të gjitha grupet e interesit, të cilët nga muaji gusht deri më 15 shtator, periudha në të cilën zgjatëm këtë konsultim publik, dhanë një kontribut të vyer, ne aktualisht kemi hedhur për konsultim publik edhe aktet nënligjore në një qasje që edhe këto duhet të diskutohen me të gjitha grupet e interesit para se të finalizohet i gjithë procesi dhe besoj se kemi arritur një komunikim të drejtpërdrejtë me ta. Sigurisht, ka pyetje dhe paqartësi, të cilat mund të vijnë kryesisht me pjesën e zgjidhjeve teknike dhe me çmimet dhe besoj se strukturat përgjegjëse që nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë të përgatitura për çdo përgjigje në vijim.

Është shumë e rëndësishme të përmendim fazat. Në fakt, propozimi ynë, që vjen si një propozim i diskutuar prej kohësh dhe i mbështetur nga kompania konsulentë, ka qenë që në të tria fazat, faza e parë të jetë ajo e marrëdhënies biznes-klient, e cila në kontekstin e fillimit të procesit juridik duhet të ishte 1 janar 2020, ne gjuam që nuk do të ishte kohë e përshtatshme për ta bërë të gjithë procesin efektiv, ndaj lejuam 6 muaj, një periudhë tranzitore, e cila të mundësojë edhe komunikimin me bizneset, edhe përshtatjen e tyre me njohjen me të gjitha zgjidhjet që ekzistojnë dhe do të ekzistojnë në treg.

Së dyti, është marrëdhënia biznes me biznes, e cila kërkon një zgjidhje teknike pak më të gjerë, sepse do të përfshijë sistemin bankar, i cili do të certifikojë se cila nga këto zgjidhje ose pagesa nuk kryhet kesh biznes me klientë, por kryhet nëpërmjet sektorit bankar në mënyrë që në periudhën finale të tij qershor-korrik 2021 do të jetë mundësia që të gjitha transaksionet të kenë evidencë jo vetëm në kohë reale, por çfarë transaksionesh janë kesh dhe çfarë transaksionesh janë kryer nëpërmjet sektorit bankar. Sigurisht, kjo është një risi shumë e rëndësishme për të certifikuar të gjithë sistemin e pagesave.

Faza biznes-qeveri përgatitja përfundon brenda një viti dhe më 1 janar 2021 do të jetë edhe ajo efektive në mënyrë që edhe sistemi i pagesave që bëhet me entet qeveritare, të jetë pjesë e këtij sistemi për të mundësuar që i gjithë sistemi të jetë në një format elektronik dhe në përdorim të të gjithë përdoruesve.

Së fundi, ngritja e regjistratit të aseteve të biznesit do të fillojë përgjatë vitit 2020 dhe do të jetë e konkluduar.

Në mbyllje më lejon të ndaj me ju se janë parashikuar të trajtohen këto akte nënligjore, të cilat, siç e thashë, do të jenë për një konsultim më të gjatë publik, sepse do të pasohen edhe me aprovimin e ligjit, por jemi të hapur që të respondojmë për çdo situatë, sikurse responduam në pjesën e ligjit.

Administrata tatimore ka filluar trajnimin e punonjësve, sepse ky është një element shumë i rëndësishëm, pasi të gjitha pyetjet që do të adresohen kanë nevojë për një përgjigje. Ne kemi një ekip të dedikuar, i cili jo vetëm po trajnohet, në kontekstin “Train dhe trainer” nga kompania konsulentë, por do të jetë aty për çdo përgjigje, zgjidhje teknike apo jo për të gjithë tatimpaguesit në Republikën e Shqipërisë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, Ministre!

Një koment para se të mbani qëndrimin tuaj: komisioni ka kërkuar të bëjë 2 ose 3 dëgjesa me grupet e interesit edhe për shkak të reflektimit të një pjese të grupeve të interesit për çështje specifike që draftligji prek. Ne si komision do të bëjmë vetë dëgjesa për sa u

përket elementeve të ligjit. Ju e thatë drejt që administrata do të jetë prezent kur ne të kemi pyetje.

Ajo që dua të ndaj me ju për rekord zyrtar, ne kemi biseduar së bashku për amendamentin që dua të bëj për rivlerësimin e banesave, por nuk dua të bëj amendament në qoftë se nuk do të kem mbështetjen e qeverisë.

Ministre, unë e kam gati amendamentin për rivlerësimin e banesave në Republikën e Shqipërisë. Ju si ministri, bini dakord që unë të avancoj amendamentin tim?

Faleminderit!

Atëherë, zyrtarisht amendamenti futet në sistem dhe, kur të kalojmë nen për nen, edhe për shkak të procedurës, të quhet sot si i përmendur, i depozituar dhe të na sugjerojë edhe sekretaria nëse duhet votuar në parim apo jo, pastaj nen për nen, sigurisht që...

Ndërkohë, do të kemi edhe një amendament tjetër të ligji i të ardhurave, te neni 27/1, që ka të bëjë me një sqarim në ndihmë të investitorëve të huaj për shkak se Kushtetuta referohet që kur ka traktate dhe marrëveshje të përjashtimit të tatimit të dyfishtë meqë administrata tatimore ka nevojë për qartësi më të madhe, megjithëse Kushtetuta e ka të qartë, po unë s'dua të bëj debat për këtë gjë, do të shtoj një fjali tek neni 27/1 ku i referohet dhe dua të shënohet zyrtarisht, ndaj po e ndaj me ministren në rekord zyrtar, me këtë përmbajtje: "Përveç rasteve kur Shqipëria ka marrëveshje të tatimit të dyfishtë" dhe jam i bindur që punonjësit tuaj e dinë se për çfarë jam duke folur, në mënyrë që kur ka investitorë të huaj që blejnë ose shesin në Republikën e Shqipërisë, të mos tatohen dyfish. Kështu që e vendosëm rekord se si do të ecim.

Qëndrimi i zotit Roshi. Lutem të jeni sa më konciz.

Artur Roshi – Vlerësoj amendamentin që ju keni depozituar dhe për shkak të vlerësimit të situatës së tërmetit, në parim do ta mbështesim, përveç ndonjë rezerve që do të diskutojmë këtu.

Sa i përket këtij projektligji, sigurisht duket luks të diskutosh pas kësaj ngjarjeje të rëndë për të gjithë shqiptarët, mirëpo buxheti është një detyrë që duhet bërë dhe duhet tejkaluar nga çdo lloj situatë, sepse ekonomia e vendit duhet të funksionojë në tërësi dhe gjithë mekanizmat që lidhen me të.

Qeveria në këtë projektligj, për mendimin tim, është e pamatur kur shikon vetëm mënyrën se si vjel taksat dhe jo mënyrën se si duhet ta ndihmojë biznesin apo i mungon koncepti i partneritetit me biznesin, sepse themi që qeveria dhe biznesi duhet të jenë partnerë, pavarësisht se nuk është koncept i qeverisjes së të majtës në tërësi, por e keni absorbuar si term dhe e ruani vetëm si slogan, ndërkohë që realisht nuk e shohim të reflektuar konkretisht në këtë projektligj.

Vrisni mendjen vetëm për informalitetin, që ai të bëhet zero, a thua se po mbeti ndonjë qindarkë në xhepat e shqiptarëve nga djersa e punës së tyre, i prish punë ekonomisë së përgjithshme të vendit. Këtu duket qartë tendenca që ju nuk interesoheni për ekonominë e shqiptarëve, por thjesht për menaxhimin e të ardhurave të tyre nën kontekstin e investimeve publike, nën kontekstin e asaj që është parimore që çdokush duhet të paguajë taksa, por duhet t'i paguajë këto taksa aq sa mundet, jo aq sa të vihen në kufijtë e mbijetesës apo kur i cenoni jetesën qytetarit. Unë nuk e shikoj qeverinë të jetë e kujdesshme në këtë kontekst.

Konsultimi publik që përmendi ministria në bindjen time është...

Arben Ahmetaj - Më falni deputetë, do t'ju lutesha të mbani qetësi në respekt të opozitës që rrallë i vjen radha të...

(Diskutim pa mikrofon)

Ju lutem! Ndërkohë që bëni bisedë, kur flet kolegu dhe ministria është prezentë...

(Diskutim pa mikrofon)

Tani ktheni përgjigje, zoti Roshi! Fokusohuni te qëndrimi!

Artur Roshi – Faleminderit, kryetar për vendosjen e balancave!

Konsultimi publik është fiktiv në bindjen time. Nuk shoh këtu reflektim të konsultimit publik me biznesin në këtë projektligj. Supozojmë për një moment që formati elektronik nuk funksionon për shkak të një virusi, që mund të futet në sistem, do të themi sërish që është prishur sistemi dhe njerëzit do të mbajnë radhë pa fund? Do të themi shqyr që bizneset paguajnë dhe që kemi qeverinë? Qeveria paska të drejtë të bëjë gabime, kurse bizneset paskan të drejtë vetëm të paguajnë dhe qeveria të marrë!

Këto dhe shumë të tjera, por duke qenë se nuk jemi në humor, preferoj të mbyll me kaq.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi, faleminderit!

Ju falënderoj edhe që ishit konciz!

Zonja Ministre, besoj se do të kalojmë te diskutimi nen për nen.

Për të mos e zgjatur seancën, se kemi votimin e të gjitha ligjeve fiskale në parim dhe të buxhetit, në emër të maxhorancës, unë do të ndaj me ju disa shqetësime paraprake dhe kur të vijë diskutimi nen për nen, ne do të ndalemi.

Pikë së pari, shqetësimi që ka maxhoranca është radha e aplikimit të sistemit, besoj se do të ishte në të mirë të punës, të sistemit dhe të qartësisht të tatimpaguesve që të ecnim me faza, fillimisht biznes me biznes, pastaj biznes me konsumator.

Së dyti, sistemi të jetë i thjeshtë, meraku është biznesi i vogël, se janë 110 mijë biznese të vogla, të cilat mund të kenë vështirësinë teknologjike dhe procedurale, kështu që kjo do të jetë një nga pikat që ne do të diskutojmë.

E treta, është një qëndrim i diskutuar me ju dhe me Kryeministrin e vendit, flas për kasat fiskale, të cilat do të vazhdojnë të qëndrojnë. Do të detyrohem të bëjmë harmonizim mes kasave fiskale, memories fiskale, që nuk kemi ndërmend ta fshijmë, me sistemin e ri, pra harmonizim mes sistemeve duke konverguar në sistemin qendror, që po ndërtohet. Pjesa tjetër, siç ju ka referuar edhe biznesi, është niveli i kesh-it të arkës, që do ta diskutojmë bashkë. Te biznesi i vogël shqetësimi është detajim i deklaruar kod më kod, që është i vështirë edhe në vendet e Europës, e jo më në Shqipëri, kështu që ky do të jetë një nga pikat e diskutimit. Kemi shumë punë për të bërë fatmirësisht, por edhe fatkeqësisht, sepse na duhet të merremi edhe me gjëra të tjera, si ju, ashtu edhe ne.

Unë po i ngre si pyetje retorike për t'ju treguar gjendjen që do të kemi gjatë diskutimit nen për nen. Duhet të jetë pa kosto të re për biznesin, pra sa kushton firma elektronike....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Roshi, në respekt të shqetësimeve të sipërmarrjes, bëni mirë të dëgjoni. Pra, sa do të kushtojë firma elektronike, sa do të kushtojë mirëmbajtja e një softi? Këto i duam të sakta.

Shqetësimi tjetër është kush certifikon, cilat janë kompanitë? Janë me 18 punonjës apo me 3? Çfarë do të thotë kjo për sigurinë e sistemit, për koston dhe pse është decentralizuar certifikimi dhe mirëmbajtja.

Këtyre pyetjeve ne do t'u hyjmë në detaje gjatë diskutimit nen për nen.

Zonja Ministre, meqë ju, në momentin që e thashë, ishit në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, në diskutimin që është bërë edhe në Komitetin e Rindërtimit do të ketë ndryshime në formatin e buxhetit, prandaj ne sot do ta kalojmë në parim dhe më pas do të diskutohet për riformatim përfundimtar, unë po e them sërish zyrtarisht që Kryeministri ka iniciuar futjen në buxhetin e vitit 2020 programin e rindërtimit, i cili kur të përfundojë, ai do ta prezantojë vetë si nismëtar, por edhe si institucioni përgjegjës për zbatimin e programit. Ne do të punojmë ngushtë me Ministrinë e Financave për t'i riparë ditët në vijim dhe pasi ta prezantojë Kryeministri, do ta prezantojmë edhe ne publikut dhe në pas në Kuvend.

Faleminderit, Ministre!

A keni ndonjë merak para se të mbyll diskutimin për ligjin? Nëse jo ne kemi kohë nen për nen sa të duam.

Anila Denaj – Nëse më lejoni kam vetëm një sqarim për amendamentet, konkretisht për nenin 27/1, propozimi ynë do të ishte: në fund të pikës 1 të nenit 27/1 të shënohet fjalia me këtë përmbajtje “Kjo pikë nuk zbatohet...”...

Arben Ahmetaj – Ministre, ju kërkoj ndjesë, por e kam për sqarim. Jo me ligjin e fiskalizimit, por me dy amendamentet. Mbani qëndrim zyrtar!

Anila Denaj – Po them si do ta propozonte ministria nëse do të kishte mundësi, që ta shohë. Meqenëse ju përmendët dy amendamentet, tek e para ajo që kemi folur në një diskutim paraprak këtu për nenin 27/1, i cili nuk është diskutuar më parë. Më lejoni të them propozimin tonë si Ministri i Financave, pra mënyrën si mund të ishte shkruar. Në fund të pikës 1 të nenit 27/1 të shënohet fjalia me këtë përmbajtje “Kjo pikë nuk zbatohet në rastet kur aksionari është rezident në një vend me të cilin Shqipëria ka marrëveshje për shmangie të taksimit të dyfishtë”.

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, do ta diskutojmë bashkë, jam shumë i qartë, e kemi shkruar vitin e kaluar me kujdes, pavarësisht se është shumë i qartë ashtu siç është, por do të na duhet të punojmë bashkë për ta qartësuar.

Anila Denaj – Kështu që edhe ne, në këtë aspekt jemi shumë dakord për të shkuar drejt këtij amendamenti. Për sa i përket fiskalizimit, më lejoni të jap vetëm një shpjegim në vija të përgjithshme pse është kjo radhë, pastaj të shkojmë në diskutime nen për nen. Më duhet të jem shumë transparente, sepse në grupet e interesit u diskutua edhe radha, sidomos nga shoqata e biznesit çështja e radhës, për faktin se ligji do të fillonte zbatimin e tij më 1 janar 2020, kishin dy shqetësime: a jemi gati për 1 janar 2020 dhe a janë të gjitha zgjidhjet aty të testuara për të gjitha bizneset, që efektiviteti i këtij ligji të ndodhë praktikisht në 1 janar 2020. Propozimet nga grupet e interesit ishin që të fillonte *business to business* pastaj *business to customer*, të cilat u sollën si një propozim që në vendet e tjera ka ndodhur më parë. Në fakt këtë kemi diskutuar edhe në grupin e komitetit që kemi ngritur në Ministrinë e Financave që ditën e parë që ky ligj u hodh për konsultim publik dhe me kompaninë e konsulencës, e cila na mbështet në këtë proces. Marrëdhënia *business to customer* është një marrëdhënie, që nuk gjykohet që në harkun kohor të 6 muajve mund të sjellë një shqetësim të konsiderueshëm, pasi është një zgjidhje teknologjike dhe *software* me shumë se sa *hardware*. Sigurisht zgjidhja *hardware* do të duhet të adoptohet për t’iu përshtatur zgjidhjes *software*, por si për çdo përditësim i teknologjisë së informacionit periudha 6-mujore është më se e përshtatshme që kjo të ndodhë, sigurisht me një informacion të zgjeruar për të gjithë tatimpaguesve. Radha e aplikimit *business to business* do ta shtynte te gjithë procesin me një vit e gjysmë. Këtë unë dua të bëj prezente dhe mes dy alternativave, si ministri do të thosha që ta konsideronim fillimin e këtij projektligji për të dhënë një rezultat më të shpejtë në kohë, duke menduar që 6-mujorshi është një periudhë tranzitore, e cila shërben për të zgjidhur këtë vakum pikëpyetjesh.

Megjithatë ne do të kalojmë nen për nen dhe do ta shikojmë. Në aspekt me të gjitha zgjidhjet teknike, unë besoj se do të kemi kohë të mjaftueshme për t'i parë të gjitha nen për nen.

Keshi i arkës është një nga nenet që ne e kemi ndryshuar në limit, por besoj kur të vijmë te kjo pikë, edhe nëse ka çështje për t'u zgjidhur, do t'i adresojmë.

Për sa i përket kodifikimit të produkteve është e vërtetë ajo që ju thatë se ka vende, të cilat marrin shumë kohë për të bërë kodifikimin e produkteve për të gjithë listën e produkteve. Faktikisht, na është sugjeruar që ky proces mund të zgjasë një vit e gjysmë. Duke menduar që vetë procesi i fiskalizimit në të gjithë komponentët e tij është një vit e gjysmë, procesin e kodifikimit e kemi vendosur si një platformë që do ta zhvillojmë për një vit e gjysmë. Megjithatë, për produktet kryesore dhe për sektorët kyç, të cilët mund të ndodhin në gjendje të një risku më të shtuar në kontekstin e qarkullimit të mallrave dhe në dijen e administratës tatimore të ketë informacion në kohë reale, të paktën për 100 produkte mendohet që këtë të na e japë kompania e konsulencës aktuale përpara se të mbarojë gjithë procesi ...

Arben Ahmetaj – Kompania e konsulencës?

Anila Denaj – Po.

Arben Ahmetaj – Ministre, ju, unë dhe ky komision kemi përgjegjësi të drejtpërdrejtë politike dhe teknike, prandaj duhet ta shikojmë me vëmendje këtë pikë në mënyrë që të mos krijojmë ndonjë konfuzion te biznesi i vogël. Pra, e kam merak këtë pjesë.

Anila Denaj – Po flisja si zgjidhje teknike, jo për çështjen si do të punojmë ne në raport me zgjidhjen.

Arben Ahmetaj – Flas për kodifikimin. Kodifikimi te biznesi i vogël ka atë vështirësi që ju e dini shumë mirë. Ju ftoj ta diskutojmë nen për nen për të parë edhe çfarë do të ndodhte në terrenin ekonomik te biznesi i vogël.

Anila Denaj – Sigurisht, por kur flasim për 100 produkte, nuk flasim për biznesin e vogël të prekshëm, por për ... Ne do të japim listën dhe do ta ...

Arben Ahmetaj – Jo, jo, jam i qartë. Duhet shkuar në ligj.

Anila Denaj – Për zbatimin e këtij ligji kodifikimi nuk është i detyrueshëm. Megjithatë ne do të flasim nen për nen për ta parë, sepse ne duam një sistem ...

Arben Ahmetaj– Të mos e shprehim, por të jetë pjesë e akteve nënligjore, kur ju të hartoni aktet nënligjore.

Anila Denaj – E fundit gjë që kam për të thënë ka të bëjë me strukturat që certifikojnë dhe cilat janë kriteret.

Ne kemi bërë gati një draft, VKM, i cili në dijeninë tonë do të dalë sot. Për këtë arsye është e nevojshme ta kalojmë edhe për informacion në këtë diskutim. Ne e kemi diskutuar edhe sëbashku që për ne, sikurse edhe për ju, është shumë e rëndësishme që kriteret të përcaktojnë cilësinë. Sigurisht, jemi të hapur për të parë nga ju nëse këto kriteret të vendosura nga ne janë brenda atij kuadri të cilësisë, por institucionet të cilat certifikojnë këto kompani janë AKSHI dhe Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve. Kriteret janë vendosur në raport me numrin e punonjësve, për të siguruar një bazë informacioni në kontekstin lokal ose të qendëruar, ashtu edhe atë rajonal, sepse një kompani mund të jetë me një shtrirje më të gjerë. Për disa kriteret dhe nevoja teknike duhet të ketë staf të mjaftueshëm për të gjitha teknikalitetet që ky proces do të dojë të mbulojë. Sikurse, transaksioni në qarkullim tregon që një kompani nuk është relativisht e vogël, por është një kompani e mesme në fushën e IT-së, telekomunikacionit dhe të kasave fiskale.

E fundit, janë çështjet që lidhen me kohën në treg. Kemi gjykuar që koha prej një viti të jetë minimalja për të përcaktuar ekzistencën e një kompanie serioze me projekte, të cilat mundet të merren në konsideratë për cilësinë. Këto janë në vija të përgjithshme.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Ideja jonë ishte të vendosnim një inventar të çështjeve që do të diskutojmë nën për nen.

Meqenëse nuk ka më as qëndrime dhe as pyetje, unë mendoj të kalojmë në procedurën e votimit. Së pari, në mos gaboj, duhen votuar ligjet fiskale me raportet e komisioneve. Kam një pyetje për sekretarinë: të dy amendamentet e mija kanë kohë për nen për nen, apo jo? Gjithsesi, për rekord e vendosa me ju.

Fillojmë me votimin e ligjeve.

Do të kemi vetëm votim në parim.

Fillojmë me propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 99/20, datë 19. 5. 2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar””.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin në parim të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar””.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vazhdojmë me propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28. 7. 2008, “Për taksat kombëtare, të ndryshuar””.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vetëm ligji i fiskalizimit ka mbetur?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, katër ligje. Ky është i katërti.

Votojmë në parim projektligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te draftligji i buxhetit të shtetit të vitit 2020.

Para se ta votojmë në parim, do të kalojmë te shqyrtimi i raporteve të komisioneve të tjera. Komisionet e tjera kanë paraqitur raportet për vlerësimin në parim të projektbuxhetit. Të gjitha komisionet e kanë miratuar projektbuxhetin me shumicë votash, duke dhënë edhe argumente. Ka kërkesa specifike, për të cilat ne do të diskutojmë, gjykojmë dhe vendosim gjatë diskutimeve nen për nen. Kalojmë te votimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Kemi lënë ligjin për të ardhurat, ndoshta?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndjesë, i kthehem ligjit për të ardhurat.

Propozim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat, të ndryshuar””.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Për regjistrim të procedurës, e votojmë edhe një herë në parim draftligjin për buxhetin e vitit 2020.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Atëherë, miratohet paketa në parim dhe projektligji i buxhetit të vitit 2020.

Kemi diskutime të gjata në detaje dhe nen për nen.

Faleminderit, zonja Ministre!

Faleminderit komisionit!

Shihemi së shpejti!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti